

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **217-24-11069-1-1-1**

Nr i brendshëm: **21700/24/077/111**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Sabit Makiqi B.I. A & V – Collection

Mulla Idriz Gjilani LL/9/A Prishtine

Prishtinë

10 000

044 477 000

Sabit Makiqi

av.runners@hotmail.com

04.04.2025



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

1. Njoftimi për kontratë i datës 06.11.2024
2. Dosja e tenderit e korrigjuar e datës 08.01.2025
3. Procesverbali i hapjes i datës 28.01.2025.
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se B-58, i datës 18.03.2025.
5. 5. Kërkesa për Rishqyrtim 21.03.2025
6. 6. Refuzimi i AK-se 25.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

Po ☒ Jo ☐

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

Po ☒ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;
- Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë
- Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te RrPP-se 02/2024.Neni 16 –

Regjistri permbledhes i Prokurimit,

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 97 Shkeljet e Renda

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Udhëzuesit 02/2024

Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te pa kënaqur me njoftimin e date 18.03.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) **MINISTRIA E MBROJTJES** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor për nevojat e FSK-së**" me nr. te prokurimit: **217-24-11069-1-1-1** dhe Nr. i brendshëm: **21700/24/077/111** në afatin ligjor komfor nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pranë Autoritetit kontraktues **MINISTRIA E MBROJTJES** ushtrojmë këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**:

- ne mënyrë te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit pasi qe ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.
- AK na ka diskriminuar haptas ne këtë tender në bazë te kërkesave dhe sqarimeve te dosje se tenderit qe jane aplikuar ne ketë tender.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Autoriteti Kontraktues **MINISTRIA E MBROJTJES** me datën 03.10.2023 ka Publikuar njoftimin B58 ku e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit, ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se.

Me poshtë po e paraqesim letrën standarde për eliminim te cilën AK na ka dërguar.

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ²

Sabit Makiqi B.I. A&V – Collection NP; MULLA IDRIZ GJILANI, PRISHTINË

Ministria e Mbrojtjes, Kazerma “Adem JASHARI”, Prishtinë

**“Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor për nevojat e FSK-së”
Nr. i prokurimit 217-24-11069-1-1-1 & Nr. i brendshëm 21700/24/077/111**

I/e nderuar(a),

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”. *Tenderi juaj* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*.

Arsyet e refuzimit të ofertës suaj:

Nuk ka plotësuar minimumin e kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit* lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale sepse OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

1. Referencat:

- Referenca me kompani private nuk ka bashkangjitur fare qarkullime bankare si: Banana store, Kastrati, Rina comerce, Nora market, Runners;
- Për Projektin nr.1 në listën e kontratave prej 1,134.364.00 euro nuk ka fare reference të bashkangjitur;
- Për Projektin nr.7 në listën e kontratave prej 441,792 euro është kontrate e papërfunduar,
- Projekti nr.8 dhe 9 të paraqitur në listën e kontratave, janë kontrata të pa përfunduara (nuk ka referenca).
- Projekti nr.10 Furnizim me uniforma të zjarrefikjes për nevojat e FSK referenca nuk është lëshuar nga MM por nga OE Runway kompani private.

2. Atesti i Astarit i kapelave dhe uniformave:

Kërkesa në DT, tek aneksi 1 masa e astarit është specifikuar: 80 g/m² (± 5%), ndërsa metoda testuese është specifikuar: EN ISO 3801:1977 PART III, ndërsa rezultati që ka paraqit OE në atest është 103 g/m², rezultat ky i cili është jashtë tolerancës së lejuar në DT.

Kërkesa në DT, tek aneksi 1, qëndrueshmëria ndaj pastrimit-EN ISO 12947 -1,2 /9kPA, pas sqarimeve gjatë fazës para hapjes së ofertave është përcaktuar/lejuar min. 20.000 përdorime, ndërsa rezultati i testit të OE është >10 000, pra më shumë se 10 000 përdorime, mirëpo jo min. 20 000 përdorime.

3. Mungon certifikata OEKO TEX lidhje me madhësinë e penjëve,

4. Produkti nr. 42 - Në DT është kërkuar që shollat e këpucëve duhet të jenë të qëndrueshme për larje në 30°C dhe pjesa e këpucëve që ka kontakt të drejtpërdrejtë me dysheme, duhet të jetë e qëndrueshme ndaj nxehtësisë deri në 140 °C, duhet të jetë e qëndrueshme ndaj vajrave/karburanteve. Në raportin e testimi të prezantuar nga OE mungojnë këto rezultate dhe nuk janë prezantuar fare.

Nga të gjeturat e larte shënuar AK konstaton se oferta është teknikisht e papërgjegjshme dhe është e eliminuar nga vlerësimi i mëtutjeshme.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Arsim TAHIRI

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)



(Nënshkrimi)

Ne si kompani kemi bere kerkesen per Rishqyrtim ne AK ne Ministrin e Mbrojtjes, mirepo AK-ja nuk ka ofruar fakte e as deshmi kuduhet te jep arsytime ne pretendimet ankimore tona qe e ka obligim ne baze te nenit 108A per tu pergjigjur ne pretendimet tona ankimore. Me kete mundem ne me konsideruar se AK-ja eshte pajtuar me pretendimet tona, dhe me faktet qe ja kemi ofruar ne kerkesen per rishqyrtim pasi nuk eshte pergjigjur ne pretendimet tona.

Po i sqarojmë pikat e eliminimit ku sipas AK-se nuk i plotësojmë dhe se mungojnë disa standarde te testimi te kërkuara ne specifikat teknike ku një nga një po i sqarojmë si me poshtë:

Sipas AK-se:

1.

Pretendimi 1

AK- e Ministrisë së Mbrojtjes ka bere shkelje te LPP-se nenin 59, 69 pasi nuk ka vlerësuar ofertën e sipas kërkesa te dosjes se tenderit lidhur me referencat pasi ne e kemi dorëzuar listën dhe referencat. Sa i përket Referencave me kompanitë private Banan store, Kastrati, Runners është dashur ti kërkoj pagesat ne ju kishim dërguar si dhe referencat tjera ne baze nenit 10 te Udhëzuesit duhet te kërkohe.. Sa i përket referencës nr. 7 te lista e kontratave kjo reference duhet te pranohet pasi është liferuar malli për at pjesë/vite është lëshuar referenca dhe AK qe ka lëshuar referencën ka qene i kënaqur kështu qe duhet te pranohet referenca për vlerën e lëshuar. Gjithashtu edhe referenca qe është lëshuar nga Runway shpk ne e kemi dorëzuar pagesën si dëshmi siç kërkohe me LPP-ne kështu qe ne AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me nenin 69 te LPP-se kur kane vlerësuar gjera te pa qëndrueshme dhe ne kundërshtim me kriteret e dosjes se tenderit ky është një

diskriminim i hapur i komisionit te vlerësimit ndaj neve si OE ku shihet qarte se AK është e obliguar me Ligj qe te na trajtoj barabarte ne përputhje me LPP_ne te gjithë OE-te qe ofertojmë e jo te na diskriminoj hapur.

2.

Pretendimi 2

Sa i përket pikës 2 te Astari i kapelave qe kane cekur si arsye për eliminimin kjo është sqaruar me pyetje sqaruese te datës 27.12.2024 përgjigjja nr. 4 pasi kane lejuar te behet me metoda tjera te ndryshimit e ne këtë raste nuk mundet te arrihet gramazhët e kërkuar gjithnjë duke u thirrur sipas testimeve te Laboratorit. Qëndrueshmëria ndaj pastrimit është bere përmisimi me sqarim te datës 27.12.2024 ku me këtë sqarim kërkesat janë permisuar, kjo vërehet te nr. 5 ne kemi bere sipas metodës te standardit qe është kërkuar ne specifikim teknik EN ISO 12947 -2 ky standard lidhet me testimin ndaj gërryerjes te tekstileve përmes metodën Martindale qe astari i kapuçit nuk mundet te ketë gërryerje pasi nuk ka lëvizje te shumta. Rezultati i laboratorit >10 000 cikle do te thotë qe materiali i testuar ka kaluar me shume se 10 000 cikle Martindale pa degraduar -pa u thyer.

Ne baze te këtij standardi kur kalon me shume se 10 000 cikle ky standard zakonisht nënkupton një nivel te mire rezistencës ndaj gërryerjes i përshtatshëm për përdorim te moderuar deri intensive varësisht nga aplikimi, pra ne dosje te tenderit nuk është cekur se astari për kapela/uniformat do te përdoren ne ambiente te hapura apo ne ambiente te mbyllura.

Astari është material terciar dhe nuk është material kryesor i kapelave dhe uniformave pasi kjo nuk mundet te këtë gërryerje dhe si material terciar nuk mundet te vije deri te dëmtim i madh pasi është si material terciar brenda kapelës i materialit kryesor.

Ne baze te kësaj ne kemi kërkuar një sqarim me detal me na shpjeguar nga laboratorit lidhur me këtë standard te Astarit, laboratorit na ka dërguar përgjigjen se Astari i juaj e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit.

Shikoni përgjigjen e laboratorit:

1/ Regarding Fabric mass per unit area

Specification: The tender requires a fabric mass of 80 g/m² with a tolerance of ±5%.

Test result: The tested fabric showed a higher mass.

Clarification:

• Measurement variations: According to ISO 3801:1977, variations in the fabric structure can lead to differences between the mass per unit length and the mass per unit area.

The slight deviation and the slightly higher fabric mass are a prerequisite for higher strength and durability, and do not significantly affect the fitness of the fabric for its intended purpose.

2/ Regarding Abrasion resistance

Specification: The tender requires an abrasion resistance of 20,000 cycles.

Test result: The fabric was tested using the Martindale method and withstood more than 10,000 cycles without tearing the fabric.

Clarification:

• Reporting standards: ISO 12947-1:1998 specifies the requirements for the Martindale abrasion testing apparatus and auxiliary materials for use in the test methods specified in Parts 2 to 4 for determining the abrasion resistance of fabrics.

A result of over 10,000 cycles indicates significant durability and suitability for the intended application. If necessary, the test may be continued to the end point of 2-thread breakage as per the standard.

We consider this result to be acceptable for the intended application - hat and uniform lining.

Eng. Miglena Kosturkova
Head of laboratory



3.

Pretendimi 3

Si pike e eliminimit sipas AK-së është se : **Mungon certifikata OEKO TEX lidhje me madhësinë e penjve.** sqarojmë se, nuk qëndrojnë këto konstatime pasi kjo certifikatë e kërkuar nga AK-ja ne kërkesat kualifikuese ne DT dhe ne njoftimin për kontratë nuk ka qene e kërkuar **Certifikata OEKO TEX** si kriter kualifikues. Certifikata OEKO TEX ka qene e kërkuar te specifikimi teknik i DT, qe i bije se duhet te sigurohet me dorëzimin e produktit dhe jo ne fazën e ofertës.

Gjithashtu sa i përket kësaj arsye te eliminimit janë te lëshuar disa vendime te OSHP-se si Vendimi me nr. 2024/0976, 2024/0974 , 2024/0980, 2024/0995 nuk qëndron konstatimi i AK-se dhe i komisionit te vlerësimit pasi qe qarte shihet se nuk ka bere vlerësim ne përputhje me nenin 59 te LPP-se. Ne baze te nenit 59 vlerësimi i ofertave AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm

vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK- e Ministrisë së Mbrojtjes ka bërë shkelje të LPP-se nën 59 pasi nuk ka vlerësuar ofertën e sipas kërkesës të dosjes së tenderit, gjithashtu komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertën as sipas nenit 72 të LPP-se pasi Autoriteti Kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë Certifikatat dhe dokumentet e paraqitura para njoftimit për kontratë.

4.

Pretendimi 4

Në bazë të specifikimit është kërkuar në DT standardi 20347-2012 kompania jone ka ofruar në atest e kemi të cekur : se shtrembi i këpucëve është i qëndrueshëm deri **30°C** për rezistencë ndaj shollës së sipërme, përshkueshmëria e ujit rreth 60 minutave , reziston ndaj thithja e ujit sipas standardit që keni kërkuar.

No	Name of the characteristic/ quantity	Measurement unit	Standards / Validated method	Sample No in the Lab Journal	Test results	Value of uncertainty U	Value and Tolerance of the characteristic	Test Conditions
1	2	3	4	5	6	7	8	9
							Technical specification	
1.	Linear density - warp	Ne	BDS EN ISO 2060:1999 /EN ISO 2060:1995/	3462	30/2	-	(30/2) ± 2 %	-
	- weft				30/2	-	(30/2) ± 2 %	
							Technical specification EN ISO 20347:2022	
	Whole shoe Resistance to separation upper/outsole: - direct molding method	N/mm	BDS EN ISO 20344:2022 pt. 5.2 /EN ISO 20344:2021/ BDS EN ISO 20344:2022/A1:2024 /EN ISO 20344:2021/ A1:2024/	3461	4,4	1,0	≥ 4,0	t (23 ± 2)°C rh (50 ± 5) %
	Upper Water permeability	g	BDS EN ISO 20344:2022 pt. 6.13 /EN ISO 20344:2021/ BDS EN ISO 20344:2022/A1:2024 /EN ISO 20344:2021/ A1:2024/	3461	0,01	-	≤ 0,20	t (23 ± 2)°C rh (50 ± 5) % - after 60 min
	Water absorption	%	BDS EN ISO 20344:2022 pt. 6.13 /EN ISO 20344:2021/ large laboratory	3461	8,5	2,9	≤ 30,0	t (23 ± 2)°C rh (50 ± 5) % - after 60 min

Ju si AK në sqarimin/përgjigjet që i keni dërguar 24.12.2024 keni cekur se vlejné edhe standarde tjera të ngjashme-ejkujvalente por në përputhje me kërkesat e sigurisë për mbrojtjen personale, të cilat janë specifikuar në standardin e harmonizuar nr EN ISO 20347:2012 lejohet testime i standardeve me të reja. Në këtë rast në kemi bërë testime me standarde ekuivalente dhe me të reja që janë në përputhshmëri me standardin EN ISO 20347: 2012 . Shikoni përgjigjen e AK-së me sqarim.

Përgjigje 6:

Sa i përket standardit EURO-DAN, në specifika teknike ne DT është kërkuar që pjesa e këpucëve që ka kontakt të drejtpërdrejtë me dysheme, duhet të jetë e qëndrueshme ndaj nxehtësisë deri në 140 °C, duhet të jetë e qëndrueshme ndaj vajrave/karburanteve dhe të ketë të integruar EURO-DAN, nëse ky lloj standardi favorizon ndonjë brend, për mundësinë e hapjes së konkurrencës vlejshme edhe standarde të ngjashme ose ekuivalente, ndërsa në përputhje me kërkesat e sigurisë për mbrojtjen personale, të cilat janë të specifikuara në standardin e harmonizuar nr. EN ISO 20347: 2012, lejohet testimi me standarde më të reja

Siç po shihet me lartë AK e ka anuluar kundërligjshëm këtë aktivitet të prokurimit pasi që neve i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në NJK dhe DT pra kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm dhe me **Çmimin më të ulët**.

Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe në pikën 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

AK nuk i ka vlerësuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-te të cilët kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 60 të LPP-së kriteri kryesor

për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**, ku neve kemi ofertuar me ofertuar me Tender të **përgjegjshëm** dhe me **Çmimin më të ulët**.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit dhe me **Çmimin më të ulët**.

Pretendimi 5

AK i MINISTRIA E MBROJTJES ka bere shkelje te nenit 62 te LPP-se pasi arsyet e anulimit te tenderit nuk qëndrojnë pasi ne i jemi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë kriteret e kërkuar ne dosjen e tenderit dhe nuk kane te drejt ne baze te ligjit AK i MINISTRIA E MBROJTJES te anuloi një tender pa i vërtetuar te gjitha dokumentet e ofertës se a janë ne përputhje me kriteret e kërkuar dhe a janë sipas 59 te LPP_-se.

Ne baze te nenit 62 anulohet një Aktivitet i prokurimit kur është bere shkelje apo nuk mundet te behet dhënia e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

- 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:
 - 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Pretendimi 6

AK-ja ne baze te LPP-se nenit 72 nenit 10 te Udhëzuesit si dhe ne baze nenit 72 duhet te kërkohen referencat, duhet te kërkohen pagesat për referencat për kompanitë private.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit prandaj, Kërkojmë nga OSHP-ja qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi dhe ti respektoj kërkesat e DT qe i ka vendosur ne NJK dhe DT lidhur ne këtë aktivitet te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M


I. APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik: Sabit Makiqi B.I A&V Collection lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së* me nr. te prokurimit: 217-24-11069-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 21700/24/077/111 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES**

II. ANULOHET njoftimi B-58 per anulim te aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: *Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me nr. te prokurimit: 217-24-11069-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 21700/24/077/111 te iniciuar nga AK- **MINISTRIA E MBROJTJES***, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

8. Dëmet materiale

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet për përgatitjen e mostrave, shpenzimet për punimin ndërkombëtar, shpenzimet për shërbime te avokatisë dhe fitimin e humbur 35.000.00 €

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent / Agencija Emergentnog Upravljanja / Emergency Management Agency

DATË /A:	26.04.2021
REFERENCE:	DP/AME - 01/2021
PËR/ZA/TO:	O.E „ A & V COLLECTION (Sabit Makiqi B.I) ”
CC:	-
PËRMES/PREKO/THROUGH:	-
NGA/OD/FROM:	Lulzim Bajrami, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Referencë

Në bazë të kërkesës e Operatorit Ekonomik „ A & V COLLECTION (Sabit Makiqi B.I) ” Divizioni i Prokurimit lëshonë këtë:

R E F E R E N C Ë

Me këtë vërtetojm se operatori ekonomik „ A & V COLLECTION (Sabit Makiqi B.I) ” i përfaqësuar nga ana e z. Sabit Makiqi ne cilësin e operatorit ekonomik ka pasur kontratës publike kornizi me Agjencionin e Menaxhimit Emergjent me titullin e prokurimit „Furnizim me Uniforma dhe Helmeta Mbrotjtëse nga zjarri për Zjarrfikës - Pjesa (LOT - 1): Furnizim me Uniforma mbrotjtëse nga zjarri (Xhaketa zjarrduruese, Pantollonat zjarrdurues, Cizmet zjarrdurues, Nënkapela zjarrduruesese, Dorëzat zjarrduruese), , dhe nr. te prokurimit 214-18-007-1-1-1 ne vlerën prej 947,674.00 Euro për furnizim me artikujt si në vijim:

Nr	Përshkrimi/Artikulli	Njësia matëse	Sasia	Furnizimi shtesë	Totali i sasive te
				Sasit	Furnizimeve
1.	Xhaketë zjarrduruese	Pale	1066	210	1276
2.	Pantollonat zjardurues	Pale	1066	210	1276
3.	Çizmet zjarrduruese	Pale	1066	210	1276
4.	Nënkapela zjarrduruese	Cope	1066	210	1276
5.	Dorëzat zjarrduruese	Pale	1066	210	1276

Vlerat e furnizimeve te operatorit ekonomik sipas viteve 2019,2021 dhe 2021 kan qenë si në vijim:

1. Furnizimi ne vitin 2019 ka qenë – 534,289.00 euro
2. Furnizimi ne vitin 2020 ka qenë – 317,373.00 euro
3. Furnizimi ne vitin 2021 ka qenë – 96,012.00 euro + 186,690.00 euro = 282,702.00 euro

Totali i përgjithshëm i furnizimit sipas kontratë është – 947,674.00 Euro .

Totali i furnizimit shtesë është – 186,690.00 euro për 210 palë

TOTALI PËRGJITHSËM ËSHTË: = 1,134,364.00 euro për 1,276 palë.

Vlenë të thekësojm se operatori ekonomik me përpikëri dhe seriozitet in është përgjegjur çdo kërkesë te AK-së për furnizim dhe i njëjti ka respektuar ne plotëni afatet e furnizimeve dhe kushteve te kontratës.

Me respekt.